

KUSHTET E PËRGJITHSHME KONTRATA E SIGURIMIT "JETË & AKSIDENTE NË GRUP"

KAPITULLI I

1. PËRCAKTIME

- 1.1. Kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të Jetës dhe Aksidenteve në Grup, polica e sigurimit dhe dokumentacioni që i bashkëlidhet atyre, do të quhet **"Kontrata e Sigurimit"**.
- 1.2. Kushtet e përgjithshme (dhe të veçanta nëse ka) të kontratës së sigurimit të Jetës dhe Aksidenteve në Grup, do të quhen **"Kushtet e Sigurimit"**.
- 1.3. Shoqëria e Sigurimit "Albsig Jetë", do të quhet **"Siguruesi"**.
- 1.4. Grupi i përbërë prej më shumë se 5 personash dhe që kanë të drejtë të sigurohen me këtë kontratë, do të quhet **"Grup i Siguruar"**.
- 1.5. Personi fizik, pjesëmarrës në Grupin e siguruar, jeta e të cilit do të sigurohet sipas kontratës së sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"I Siguruari"**.
- 1.6. Personi fizik apo juridik, që nënshkruan kontratën e sigurimit, do të quhet **"Kontraktuesi"**.
- 1.7. Dokumenti që provon lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Polica e Sigurimit"**.
- 1.8. Dëshmia e sigurimit që "Siguruesi" i lëshon të "Siguruarit, do të quhet **"Certifikatë e Sigurimit"**.
- 1.9. Personi fizik apo juridik, që përfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazën e vullnetit të shprehur nga i siguruari në certifikatën e sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Përfituesi"**.
- 1.10. Shuma e mjeteve monetare që i Siguruari dhe/ose kontraktuesi i paguajnë Siguruesit për lidhjen e kësaj kontrate, këtu e më poshtë, do të quhet **"Prim i Sigurimit"**.
- 1.11. Shuma maksimale e mjeteve monetare, që Siguruesi merr përsipër të paguajë me vërtetimin e rastit të sigurimit, në favor të të Siguruarit apo Përfituesit, do të quhet **"Shuma e Sigurimit"**.
- 1.12. Shuma e mjeteve monetare, që Siguruesi i paguan të Siguruarit apo Përfituesit, me vërtetimin e ngjarjes së sigurimit, do të quhet **"Përfitim"**.
- 1.13. Në rastet kur pagesa e Primit të Sigurimit, sipas kushteve të kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga i siguruari, tërësisht ose pjesërisht, kjo kontratë do të quhet **"Kontratë sigurimi kontributor në grup"**.
- 1.14. Në rastet kur pagesa e Primit të Sigurimit, sipas kushteve të kësaj kontrate sigurimi, do të bëhet nga punëdhënësi, kjo kontratë do të quhet **"Kontratë sigurimi në grup"**.
- 1.15. Punëdhënësi i cili paguan plotësisht apo pjesërisht primin në favor të të Siguruarit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Policëmbajtësi"**.
- 1.16. Vdekja e të Siguruarit, si dhe të gjitha llojet e paaftësisë së personit, kur ato nuk përfshihen në rreziqet e përjashtuara të kësaj kontrate sigurimi, do të

quhen **"Rasti i sigurimit"**.

1.17. Vdekja ose paaftësia e të Siguruarit që shkaktohen nga mjete të rastit, të dhunshme, të dukshme, të jashtme, të pavarura nga vullneti i të Siguruarit, do të quhet **"Aksident"**.

1.18. Vdekja e të Siguruarit, pavarësisht nëse është shkakuar ose jo nga Aksidenti, me përjashtim të rreziqeve të përjashtuara në këtë kontratë sigurimi, do të quhet **"Vdekja e të Siguruarit"**.

1.19. Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit për të kryer detyrat në profesionin e tij ose në çdo profesion tjetër, shkakuar nga aksidenti dhe vërtetuar si e tille nga autoriteti mjekësor kompetent, pas mbarimit të periudhës prej 1 viti nga fillimi i paaftësisë, do të quhet **"Paaftësi e përhershme e plotë"**.

1.20. Humbja e pjesëshme e aftësisë për punë, shkakuar nga aksidenti, me pasojë humbjen anatomike apo dëmtimin funksional të përhershëm të një ose disa organeve apo gjymtyrëve të të Siguruarit, do të quhet **"Paaftësi e përhershme e pjesshme"**.

1.21. Humbja e plotë e aftësisë së të Siguruarit, shkakuar nga aksidenti, për të përmbushur përkohësisht detyrat në profesionin e tij, do të quhet **"Paaftësi e përkohëshme e plotë"**.

1.22. Humbja e pjesëshme e aftësisë së Siguruarit, shkakuar nga aksidenti, për të përmbushur përkohësisht detyrat në profesionin e tij, do të quhet **"Paaftësi e përkohëshme e pjesshme"**.

1.23. Shpenzimet e kryera për trajtimin spitalor dhe ndërhyrjet kirurgjikale, shpenzimet për blerjen e medikamenteve mjekësore të rekomanduara nga mjeku, trajtimin me rreze, shpenzimet e bëra për transportimin e të Siguruarit për në spital (kur ky transportim kërkon kushte specifike) të cilat lindin si pasojë e aksidentit, do të quhen **"Shpenzime mjekësore"**.

1.24. Humbja fizike ose funksionale e një dore, në ose mbi artikulationin e brrylit, apo e një këmbë, në ose mbi artikulationin e gjurit, do të quhet **"Humbje gjymtyre"**.

1.25. Limiti maksimal i shumës monetare, që Siguruesi merr përsipër të paguajë, në ndodhjen e rastit të sigurimit, do të quhet **"Përgjegjësi agregate"**.

1.26. Kohëzgjatja, për të cilën është në fuqi kontrata e sigurimit, këtu e më poshtë, do të quhet **"Periudha e sigurimit"**.

KAPITULLI II

1. OBJEKTI

Me anë të kësaj Kontrate Sigurimi, siguruesi dhe i Siguruari bien dakort që kundrejt pagimit të primit të sigurimit në favor të siguruesit, në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe të veçanta (nëse ka) të kësaj kontrate, siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin në mënyrën dhe masën e parshikuar në këtë kontratë nëse ndodh dhe vërtetohet rasti i sigurimit.

2. MBULIMET

- Rrezikun e vdekjes së të siguruarit për shkaqe natyrore apo aksidentale.
- Rrezikun e mbetjes i paaftë i përhershëm për shkaqe dhe dëmtime të lidhura me aksidentin.
- Rrezikun e mbetjes i paaftë i përkohshëm për shkaqe dhe dëmtime të ardhura nga aksidenti.

3. E DREJTA PËR TË QENË I SIGURUAR

- 3.1. Kanë të drejtë të sigurohen persona me moshë nga 18 vjeç deri në 65 vjeç, anëtarë të "grupit të sigurimit".
- 3.2. Nuk do të konsiderohen të "Siguruar" dhe nuk kanë të drejtë të bëjnë pjesë në grup, sipas kushteve të sigurimit të parashikuara në këtë kontratë sigurimi, personat që nuk kanë arritur moshën 18 vjeç ose janë mbi 65 vjeç.
- 3.3. Nuk do të konsiderohen të siguruar ata persona që kërkojnë kujdes të përhershëm mjekësor ose që e mbështesin jetesën në kujdesin e të tretëve.
- 3.4. Të Siguruarit që arrijnë moshën kufi 65 vjeç, kur kontrata e sigurimit është në fuqi, do të mbeten të mbuluar deri në mbarim të afatit të treguar në këtë kontratë sigurimi.

4. PERSONI I SIGURUAR

Një person, Anëtar i grupit të sigurimit do konsiderohet i siguruar vetëm nëse është paguar primi në llogaritë e siguresit dhe është lëshuar kontrata e sigurimit.

5. HYRJA NË FUQI E KONTRATËS SË SIGURIMIT

Kontrata e Sigurimit hyn në fuqi në orën 24.00 të ditës së përcaktuar në këtë kontratë, me kusht që të jetë paguar i primi i sigurimit, apo kësti i parë i tij, në arken apo llogarinë rrjedhëse të Siguresit.

6. SHUMA E SIGURIMIT

Shumat e sigurimit që Siguruesi merr përsipër të mbulojë në rast të ndodhjes së rastit të sigurimit, variojnë nga 500.000 deri në 2.000.000 lekë.

7. GRAFIKU I PËRFITIMEVE

7.1. Grafiku i përfitimit klasifikohet nga i siguruari, duke përcaktuar shumën e sigurimit për çdonjërin prej tyre. Grafiku i përfitimeve mund të jetë i thjeshtë ose i përbërë.

7.2. Forma dhe lloji i grafikut vendosen sipas kërkesës së kontraktuesit dhe me marrëveshje midis palëve, por në asnjë rast shuma e zgjedhur e sigurimit, s'mund të jetë më e vogël se 500.000 Lekë, ose më e madhe se 2.000.000 Lekë. Për shumën më të lartë sigurimi, kërkohet miratimi me shkrim i Siguresit.

8. PËRFITIMET E PAGUESHME

8.1. Përfitimi për vdekjen Natyrore – paguhet në masën 100% të shumës së siguruar, sipas grafikut të përfitimit që i përket rrezikut të jetës në grup.

8.2. Në rast vdekje aksidentale – përfitimit të mësipërm

i bashkëngjitet përfitimi sipas grafikut të përfitimit të rrezikut të Aksidenteve Personale. Në përfitimin për vdekjen janë të përfshira të gjitha përfitimet e tjera, të pagueshme nga Siguruesi deri në momentin e ndodhjes së ngjarjes.

8.3. Përfitimi për paaftësinë e përhershme të plotë të shkaktuar nga aksidenti – do të paguhet në masën 100% të shumës së sigurimit sipas grafikut të përfitimit të rrezikut të Aksidenteve Personale. Për efekt të kësaj kontrate do të konsiderohet si e tillë:

- Humbja totale dhe e pariparueshme e shikimit në të dy sytë;
- Humbja totale nga gjymtimi fizik apo humbja e funksionit të dy duarve në ose mbi nivelin e kyçit.
- Humbje fizike apo funksionale e dy gjymtyrëve të poshtme në apo mbi artikulacionin e gjurit.
- Humbja fizike apo funksionale e një gjymtyrë të sipërme dhe një gjymtyrë të poshtme së bashku.

Me shprehjen humbje funksionale kemi parasysh Paralizat (si paraplegjia, hemiplegjia, kuadriplegjia, diplegjia).

Në të gjitha përfitimet e mësipërme është i përfshirë përfitimi për paaftësi të përkohëshme.

8.4. Përfitimi për Paaftësinë e Përhershme të pjesshme – llogaritet si përqindje mbi shumën e siguruar sipas grafikut të Aksidenteve Personale, e dëmtimit të ndodhur të shprehur në tabelën më poshtë:

NR.	Dëmtimet e Pësuar	% e Shumës së Sigurimit	
		Djathtë	Majtë
	(humbje fizike apo funksionale)		
1.	Gjymtyrë e sipërme mbi artikulacionin e bërrylit	70	60
2.	Një dorë apo parakrah	60	50
3.	Imobilitet i artikulacionit kapulo-humeral	25	20
4.	Imobilitet i artikulacionit të bërrylit	20	15
5.	Imobilitet i artikulacionit të kyçit	20	15
6.	Humbje e gishtit të madh të dorës	20	15
7.	Humbje e gishtit tregues	15	10
8.	Gishti i mesëm ose i unazës	10	05
9.	Gishti i vogël i dorës	12	10
10.	Një falangë e gishtit të madh të dorës	10	08
11.	Një falangë e gishtave të tjerë të dorës	1/3 gishtit	1/3 gishtit
12.	Humbja e një gjymtyrë të poshtme në ose mbi gju	60	60
13.	Humbja e një këmbë përfshin gishtat	50	50

NR.	Dëmtimet e Pësuar (humbje fizike apo funksionale)	% e Shumës së Sigurimit	
		Djathhtë	Majtë
14.	Imobilitet i plotë në artikulationin koksofemoral	40	40
15.	Imobilitet i plotë i artikulationit të gjurit	20	20
16.	Humbja e gishtit të madh të këmbës	08	08
17.	Gishtat e tjerë të këmbës	03	03
18.	Shkurtimi i njërës këmbë 5 cm ose më shumë	15	15
19.	Shurdhimi i plotë në të dy veshët	30	
20.	Humbja e plotë e dëgjimit në njërin vesh	10	10
21.	Pamundësi e lëvizjes së shtyllës kurizore me deformim të dukshëm	20	
22.	Humbja e plotë e shikimit në një sy	25	25

Siguruesi paguan dëmshpërblimin për pasojat e drejtpërdrejta dhe ekskluzive të shkaktuara nga aksidenti.

Në rast se shkaktohet humbja anatomike ose pakesimi funksional i nje organi ose gjymtyre të dëmtuar para aksidentit, përqindjet e treguara më sipër do të zbriten duke marrë parasysh shkallën e invaliditetit të mëparshëm.

Në rast se për shkak të aksidentit vjen si pasojë pakësimi por jo humbja e plotë, përqindjet e treguara më lart do të pakësohen në përpjestim me shkallën e humbjes anatomike apo funksionale.

Në rastet e paaftësisë së përhershme të papërcaktuar në tabelën e mësipërme përfitimi caktohet duke iu referuar përqindjeve të treguara më lart, duke patur parasysh shkallën e humbjes së aftësive normale mendore e fizike të të siguruarit.

Në rast se i Siguruari pëson humbje anatomike apo funksionale të ndryshme (të painkuadrueshme tek njëra tjetra) Siguruesi paguan përfitimin të barabartë me shumën e përqindjeve të paaftësisë për çdo humbje, por jo më shumë se 100% të shumës së siguruar sipas grafikut të përfitimeve.

8.5. Përfitimi për paaftësinë e përkohëshme të plotë — paguhet në masën 0.12% të shumës së siguruar sipas grafikut të Aksidenteve Personale, por jo më shumë se 1 200 Lekë në ditë.

8.6. Përfitimi për paaftësinë e përkohëshme të pjesshme — paguhet në masën 0.03 % të shumës së siguruar sipas grafikut të Aksidenteve Personale, por jo më shumë se 300 lekë në ditë.

Përfitimet për paaftësi të përkohëshme do të paguhet për një periudhë jo më shumë se 52 javë, por pa

përfshirë paaftësinë e të Siguarit në ditët e pushimit. Përfitimi për paaftësi të përkohëshme jepet për periudha 4 javore së bashku dhe nuk lejohet dhënia e tyre në formë paradhënie.

8.7. Përfitimi për shpenzime mjekësore — paguhet si përfitim shtesë nga Siguruesi deri në masën 15% të shumës së siguruar sipas grafikut të zgjedhur për sigurimin e Aksidenteve Personale.

Shpenzime mjekësore sipas kësaj kontate do të konsiderohen të gjitha shpenzimet e bëra për blerjen e ilaçeve, dhe paisjeve të tjera mjekësore që janë të rekomanduara nga mjeku dhe që shërbejnë direkt në trajtimin e dëmtimit të pësuar.

8.8. Përfitimi për trajtimin mjekësor jashtë shtetit — Ky përfitim paguhet vetëm në rastet kur i siguruari është siguruar me shumë sigurimi sipas grafikut të zgjedhur nga 1.500.000 e më shumë.

Përfitimi për trajtim jashtë shtetit do të jepet për të siguruarit që pësojnë dëmtime të rënda, dhe që nga organi mjekësor kompetent do të vlerësohet si e pamundur për t'u trajtuar në Shqipëri.

Në këto raste i Siguruari përfiton mbulimin e shpenzimeve të mjekimit në një klinikë të specializuar jashtë shtetit deri në shumën e sigurimit të zgjedhur për sigurimin e Aksidenteve Personale.

Përfitimi për trajtim mjekësor jashtë shtetit është i përfshirë në përfitimin e vdekjes apo paaftësisë së përhershme.

9. PËRJASHTIMET

Për efekte të kësaj kontrate sigurimi nuk do të mbulohet rasti i sigurimit shkaktuar në kushtet e:

9.1. Lufta, (vetëm nëse është e shpallur nga organet kompetente) veprimet ushtarake, lufta civile, rebelimi, kryengritje të armatosur, dhe akte terroriste.

9.2. Veprimi i armëve të shkatërrimit në masë si armët bërthamore dhe bakteriologjike.

9.3. Kontaminimit radioaktiv, shpërthimeve bërthamore, përmbajtjeve, zhvendosjes së tokës, tërmete, shpërthimeve vullkanike.

9.4. Drejtimit të mjeteve motorrike tokësore, ujore, ajrore, pa qenë i pajisur me dëshminë përkatëse të aftësisë, pjesmarrja në ngjitje alpinistike, gjatë fluturimit me avion të çdo lloji (përveç kur udhëton vetëm si pasagjer); gjatë ushtrimit të sporteve dimërore, garave me kuaj, makina dhe motoçikleta, etj.

9.5. Përdorimit të lëndëve eksplozive dhe korodive, përveç rasteve kur është në përmbushje të detyrës profesionale;

9.6. Përfshirjes së të siguruarit në veprimtari të paligjshme, apo kriminale.

9.7. Vetëvrasjes nëse ndodh brenda 6 muajve të parë të lidhjes së kontrates

9.8. Akteve të kryera me dashje apo të tentuara nga Policmbajtesi, kontraktuesi apo përfituesi në dëm të të siguruarit.

9.9. Pjesëmarrjes së të siguruarit në sulme apo

veprime e kundërveprime të dhunshme të provokuara nga të tretët, përveç kur i siguruari vepron në kushtet e vetëmbrojtjes a të nevojës ekstreme.

9.10. Influcencës së alkoolit apo drogës, sëmundjeve veneriane, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, sëmundjeve si pasojë e virusit HIV.

9.11. Çdo lloj defekti fizik apo mendor priekzistues, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i siguruari dhe është pranuar nga siguruesi.

9.12. Ndërhyrjeve kirurgjikale, kontrolleve apo kurimit për pasoja që nuk lidhen me kushtet e mbulimit në sigurim sipas kësaj kontrate.

9.13. Përjashtohen nga përfitimi për paaftësi të çdo lloji, e përhershme apo e përkohshme që shkaktohet nga sëmundje apo patologji të ekzistuar më parë apo të shfaqura pas hyrjes në fuqi të kontratës, gjatë shtatëzanisë, lindjes së fëmijës apo abortit, pavarësisht nga natyra e tyre që do të përbënin rrethanë apo fakt me njohjen e të cilave siguruesi nuk do të pranonte lidhjen e kontratës së sigurimit.

9.14. Sëmundjeve të njohura, trajtuara apo diagnostikuara përpara marrjes në sigurim.

10. RASTI I SIGURIMIT

Sipas kushteve të kësaj kontrate rast sigurimi do të quhet;

- Vdekja e personit të siguruar pavarësisht nëse ndodh nga shkaqe natyrore apo aksidentale
- Dëmtimi aksidental i të siguruarit me pasojë
 - Paaftësinë e përhershme
 - Paaftësinë e përkohshme

11. PAGIMI I PRIMEVE

11.1. Primi i sigurimit llogaritet për një vit kalendarik, por mund të paguhet deri në 3 këste brenda këtij viti kalendarik. Datat e pagimit të kësteve të primit të sigurimit do të përcaktohen në kontratën e sigurimit, sipas zgjedhjes së bërë nga Policëmbajtësi, në marrveshje me siguruesin.

11.2. Këstet e primit të sigurimit do të paguhen pranë zyrave të Siguruesit, degët/filialet në rrethe, në ditën e përcaktuar në policën e sigurimit, por jo më vonë se 15 ditë nga lindja e detyrimit.

12. MOSPAGIMI I PRIMEVE

12.1 Në qoftë se primi i sigurimit ose kësti i tij i parë nuk paguhet në afatin e caktuar në kontratën e sigurimit, mbulimi në sigurim pezullohet deri në orën 24.00 të ditës që Policëmbajtësi dhe/ose i Siguruari paguan shumën që detyrohet.

12.2 Kur Policëmbajtësi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të përcaktuara në kontratën e sigurimit, sigurimi pezullohet duke filluar nga ora 24.00 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit. Siguruesi ka të drejtë që të kërkojë zgjidhjen e kontrates së sigurimit dhe primet e paguara nuk i kthehen të Siguruarit dhe/ose Policëmbajtësit.

12.3 Në rastet e vërtetimit të ngjarjes së sigurimit gjatë periudhës 15-ditore të pezullimit të mbulimit në sigurim, Siguruesi, do të paguajë përfitimin e reduktuar në përpjestim me primin e paguar në raport me primin total.

12.4 Në rastin e vërtetimit të ngjarjes së sigurimit pas kalimit të afatit 15-ditor të pezullimit të mbulimit në sigurim dhe kësti i radhës nuk është paguar brenda këtij afati, Siguruesi nuk paguan asnjë përfitim.

13. RIAKTIVIZIMI KONTRATES

13.1 Brenda 2 muajve nga skadimi i afatit të pagesës së këstit të parë të primit të sigurimit, me kërkesën e Policëmbajtësit dhe/ose të Siguruarit dhe me pëlqimin e Siguruesit, mund të riaktivizohet kontrata e sigurimit duke paguar këstet e primeve në llogaritë e Siguruesit.

13.2 Në çdo rast mbulimi në sigurim hyn në fuqi, për të gjithë vlerën e tij në orën 24.00 të ditës së pagimit të shumës së kërkuar të primit të sigurimit.

KAPITULLI III

1. NJOFTIMET DHE DEKLARIMET

1.1. Kontraktuesi dhe/ose Policëmbajtësi duhet të dorëzojë Siguruesit, listën me identitetin e të gjithë pjesëmarrësve të grupit, moshën, çertifikatat individuale të sigurimit, policat e sigurimit, si dhe çdo informacion tjetër me shkrim që do të përcaktojë nivelin e përfitimit dhe të primit të sigurimit në këtë kontratë sigurimi dhe që janë pjesë përbërëse të saj.

1.2. Këto të dhëna i dorëzohen Siguruesit në:

- datën e fillimit të policës,
- çdo datë të rinovimit të policës,
- çastin kur çdo pjesëmarrës i përfshirë në grupin e siguruar, bëhet i sigurueshëm për një shumë më të madhe sigurimi.

1.3. Siguruesi rezervon të drejtën t'i kërkojë këto të dhëna të tjera të siguruarit dhe/ose kontraktuesit a policëmbajtësit, apo ti verifikojë ato në çdo datë kur sipas opinionit të Siguruesit është bërë një ndryshim i rëndësishëm në totalin e shumës së sigurimit në këtë policë.

2. DEKLARIMET E PASAKTA

2.1. Në rast se i Siguruari, kontraktuesi a policëmbajtësi me dashje apo nga pakujdesia ka bërë deklarime të pasakta ose ka lënë në heshtje fakte apo rrethana të tilla për të cilat Siguruesi nuk do të lidhte kontratën e sigurimit, ky i fundit ka të drejtë:

2.1.1 Të kundërshtojë vlefshmërinë e kontratës së sigurimit brenda 1 muaji nga dita që ka marrë dijeni për mossaktesinë e deklarimeve ose lënien në heshtje të tyre duke kërkuar ndryshimin e kushteve të saj;

2.1.2. Të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se ka rrethana të tilla që po ti dinte Siguruesi nuk do të kishte lidhur kontratën.

2.1.3. Të refuzojë në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit dhe në çdo kohë tjetër pagesën e përfitimeve.

2.2 Kontrata e sigurimit mbetet e vlefshme për ata të siguruar të cilëve nuk u referohen deklaratimet e pasakta apo heshtja.

2.3 Primet e sigurimit të paguara deri në kohën që kërkohet zgjidhja e kontratës së sigurimit nuk i kthehen të Siguruarit dhe/ose Policëmbajtësit.

2.4 Pas kalimit të 6 muajve nga hyrja në fuqi e kontratës së sigurimit ose e rinovimit të saj, kjo kontrate nuk mund të kundërshtohet më për deklaratimet e pasakta, ose lënien në heshtje të fakteve nga Policëmbajtësi ose i Siguruari, përveç rastit kur vërtetohet se deklarimi i pasaktë është bërë me dashje dhe për efekt përfitimi.

3. PËRFUNDIMI I MBULIMIT NË SIGURIM

3.1 Mbulimi në sigurim përfundon:

3.1.1. Kur zgjidhet kontrata e punës midis të Siguruarit dhe Policëmbajtësit ose kontraktuesit. Në kontratën e "Sigurimit kontributor në grup", kur i siguruari ka paguar pjesërisht primin e sigurimit, zgjidhja e kontratës së punës, bën që sigurimi të mbetet në fuqi deri në mbarim të periudhës së sigurimit, për vlerën e reduktuar të shumës së sigurimit në përpjestim me pagesën e primit të bërë nga i Siguruari.

3.1.2. Në mënyrë të njëanshme, kur njëra nga palët nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate sigurimi;

- kur përgjegjësia bie mbi Siguruesin, i Siguruari ose Policëmbajtësi kanë të drejtën për pjesën e primit të sigurimit të paguar.

- kur përgjegjësia bie mbi të Siguarin/policëmbajtësin, Siguruesi ka të drejtën të mos u kthejë shumën e primeve të sigurimit të paguara.

3.1.3. Kur Siguruesi konstaton rrethana të tilla, të cilat po të ishin të njohura në momentin e kërkesës për sigurim, do të përbënin shkak për moslëshimin e policës së sigurimit;

3.1.4. Kur nuk janë paguar këstet e primit të sigurimit;

3.1.5. Kur i Siguruari arrin moshën kufi të marrjes në sigurim, 65 vjeç;

3.1.6. Në çdo datë tjetër në të cilën ai nuk përmbush kushtet e marrjes në sigurim.

3.1.7. Kur është ekzekutuar plotësisht grafiku i përfitimeve ose ka mbaruar periudha e sigurimit.

4. PËRFITUESIT

4.1 Përfituesi caktohet me shkrim në kontratën e sigurimit nga i Siguruari, i cili në çdo moment mund ta revokoje ose ta ndryshojë këtë caktim, me shkrim ose me testament. Data e hyrjes në fuqi e këtij ndryshimi do të jetë data që kërkohet nga i Siguruari.

4.2 Në çdo rast, i Siguruari duhet të deklarojë dhe provojë nëse përfituesi ka dijeni për caktimin e tij si i tillë në kontratën e sigurimit.

4.3 Në rastin kur i Siguruari që ka vdekur nuk ka përcaktuar Përfituesin me vullnetin e tij, atëherë, përfitues do të jenë trashëgimtarët ligjore të të siguruarit sipas vendimit të gjykatës të formës së prerë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

5. NDODHJA E RASTIT TË SIGURIMIT

5.1 Me ndodhjen e rastit të Sigurimit, i Siguruari apo Përfituesi detyrohen të njoftojnë Siguruesin duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e tij, si dhe të zbatojnë porositë e dhëna nga Siguruesi.

5.2 Një njoftim i tillë do të quhet i dhënë Siguruesit menjëherë nëse është bërë me shkrim brenda 24 orëve nga ndodhja e Rastit të Sigurimit dhe në çdo rast, jo më vonë se 48 orë nga çasti kur i siguruari është në gjendje mendore a fizike të kryejë njoftimin, nga çasti kur familjarët e të siguruarit a përfituesi kanë dijeni për vërtetimin e ngjarjes së sigurimit.

5.3 Për të gjitha pagesat e përfitimit që do të bëjë Siguruesi duhet të dorëzohen paraprakisht këto dokumenta:

5.3.1. çertifikata e lindjes së të Siguruarit;

5.3.2. kërkesa për përfitim sëbashku me çertifikatën e Sigurimit dhe/ose policën e sigurimit

5.3.3. çdo dokument të kërkuar nga Siguruesi i cili vërteton detyrimin e tij për të paguar

5.4 Dokumentacioni i plotë i dorëzohet Siguruesit. Shpenzimet për grumbullimin dhe dërgimin e dokumentacionit janë në ngarkim të të Siguruarit a Përfituesit.

5.5 Siguruesi duhet të paguajë dëmshpërblimin që rrjedh nga kjo kontratë sigurimi brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së dokumentave të nevojshme dhe që konsiderohen të plota. Çdo pagesë bëhet në monedhën e treguar në kontratën e Sigurimit, pranë zyrave të Siguruesit.

6. REZIDENCA

I siguruari duhet të jetë rezident në Republikën e Shqipërisë përgjatë periudhës së sigurimit, por jo më pak se 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës së sigurimit. Për të huajt e punësuar në subjekte juridike me seli a veprimtari në Republikën e Shqipërisë mund të bëhet sigurimi me listë të hapur, por në çdo rast ndryshimi i listës duhet ti njoftohet Siguruesit të paktën 10 ditë më parë me shkrim dhe ky i fundit brenda 10 ditëve të japë pëlqimin e tij për këtë ndryshim.

7. CEDIMI, PENGU, BLOKIMI

I Siguruari nuk mund t'a cedojë policën e Sigurimit tek të tjeret, si dhe të vendosi si peng (garanci) ose të bllokojë shumat e sigurimit për llogari të të tretëve.

8. LËSHIMI I DUBLIKATËS

Në rast se polica origjinale e sigurimit priset, griset ose bëhet e palexueshme, Policëmbajtësi ose i Siguruari duhet të pajiset me një policë sigurimi tjetër

me shpenzimet e tyre, në të cilën përmbahet shënimi "Dublikatë".

9. PËRGJEGJËSIA AGREGATE

Limiti i përgjegjësisë që Siguruesi paguan në një aksident është 10 000 000 lekë.

Nëse përfitimet që duhet të paguhen në të njëjtin aksident e kalojnë këtë shumë, atëherë Siguruesi paguan përfitimet të reduktuara në varësi të shumave të sigurimit të zgjedhura nga të Siguruarit që janë pjesëmarës në grupin e siguruar sipas kësaj kontrate sigurimi.

10. TAKSAT DHE TATIMET

Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit janë në ngarkim të Policëmbajtësit dhe/ose të Përfituesve.

11. JURIDIKSIONI

11.1. Përfitimet e sigurimit janë të kërkuara brenda 2 vjetëve nga data e lindjes të së drejtës për kërkimin e tyre.

11.2. Mosmarreveshjet që mund të lindin, në rast se nuk zgjidhen në mirëkuptim, do të zgjidhen nga gjykata e vendit ku është lidhur kontrata e sigurimit.

11.3. Përveç rasteve kur është parashikuar shprehimisht ndryshe në dispozitat e Kontratës së sigurimit do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil.